



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 28.02.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave, 07.02.2019, 14.02.2019 dhe 19.02.2019 nga anëtarët e Këshillit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 14:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 7. Përfaqësues të USAID-it.*
- 8. Përfaqësuese e OSBE-së.*
- 9. Përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit.*

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave, 07.02.2019, 14.02.2019 dhe 19.02.2019 nga anëtarët e Këshillit.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.02.2019.

Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Rendi i ditës i kësaj mbledhjeje, ashtu sikurse jeni në dijeni, ka 7 pika, ku pika e parë është: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për datat respektive 7 shkurt, 14 shkurt dhe 19 shkurt i vitit 2019. Çështja e dytë në rendin e ditës është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin 35, datë 19.02.2019 “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”. Çështja nr. 3 është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës. Çështja 4 është: Shqyrtimi i projekt-udhëzimit “Mbi pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare” të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të

Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Çështja 5 është: Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, të gjyqtarit {...}. Çështja 6 është: Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, të gjyqtarit {...}. Dhe çështja 7 është: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Jeni dakord me rendin e ditës?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Diçka për menaxhimin e çështjeve.

A jeni dakord që çështjen nr. 2, e cila lidhet me një shtesë të vendimit 35, ta kalojmë në fund, së bashku me caktimin e gjyqtarëve, duke qenë se bëhet fjalë për të njëjtat... dhe kalojmë me miratimin e pikës 1, pika 3, pika 4, pika 5, pika 6, dhe lejmë pikën 7 dhe pikën 2 në fund, pasi bëhet fjalë për të njëjtën çështje. Dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, kalojmë tek çështja e parë. Sikurse jeni në dijeni, lidhur me miratimin e tre procesverbaleve të mbledhjeve respektive, besoj se nga anëtarët janë konsultuar procesverbalet. Jeni dakord që t'i miratojmë procesverbalet?

Kalojmë në miratimin e procesverbaleve?

Erjon Muharremaj: Faleminderit!!

Kam dy propozime në lidhje me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Së pari, propozoj amendimin e pikës 2, e cila thotë: “2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.”

Mendoj që me këtë proces duhet të merret administrata dhe jo Kryetarja e Këshillit.

Dhe propozimi im i dytë ka të bëjë me dërgimin e procesverbaleve në formë shkresore, pasi mendoj që është një shpenzim i kotë i kohës së administratës që merret me printimin dhe fotokopjimin, i bojës dhe i letrës, duke qenë që neve këto materiale na dërgohen në mënyrë shumë korrekte nga Drejtoria Juridike, parapakisht në formë elektronike. Gjykoj që nuk është e nevojshme që edhe të printohen në formë shkresore.

Mjafton versioni elektronik. Cilido që ka vërejtje, mund t'i reflektojë, nëse ka ndonjë vërejtje në lidhje me procesverbalin. Faleminderit!!

Naureda Llagami: Atëherë, të falenderoj për fjalën dhe për sugjerimet e dhëna.

Lidhur me reflektimin se kush do zbatohet për publikimin e këtyre, ne mund ta reflektojmë këtë.

Lidhur me shpërndarjen e procesverbaleve në formë shkresore, unë doja t'ju bëja dijeni që, me miratimin e uebsajtit (*website-it*) që ne kemi dakordësuar, nuk do kemi më procesverbale të detajuara, por do nxirret komplet biseda, komplet debati në audio, do publikohet tek uebsajti (*website-i*) dhe detyrimi ligjor që ne kemi është që do hartohet një përmbledhje e procesverbalit, që do ta hartojë sektori përkatës, ku ne edhe atë do ta miratojmë në vijim të mbledhjeve. Kështu që unë besoj që përmes publikimit të audios të të gjithë mbledhjeve, ne në një farë mënyre evitojmë printimet e këtyre procesverbaleve të zgjatura dhe për më tepër që mund t'i përmbledhim dhe mund të vendosim vetë formatin në të cilën ne do t'i përmbledhim, sipas kërkesave që ka parashikuar edhe ligji.

Atëherë, ta kalojmë në votim me sugjerimet që dha kolegu lidhur me pikën e dytë të miratimit? Pra: “Këshilli vendosi: Miratimin e procesverbaleve të mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 7 shkurt, 14 shkurt dhe 19 shkurt; Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e tyre administrata e Këshillit.” Na e lejon ligji atë?

Alban Toro: Neni 69, pika 3 thotë: “Procesverbali me përmbledhjen e diskutimeve bëhet publik në faqen zyrtare të internetit ... pasi miratohet nga mbledhja plenare pasardhëse e Këshillit. Edhe në këtë rast, nën përgjegjësinë e kryetarit, administrata kujdeset për të fshirë çdo referencë”, etj., etj. Pra del që është përgjegjësia e Kryetarit për zbardhjen e regjistrimeve përkatëse, kuptohet, jo direkt, por nëpërmjet stafit mbështetës. Kështu që më duket e tepërt për ta hequr këtë pjesë nga projekti.

Naureda Llagami: Atëherë, vazhdojmë me variantin e parë.

Jemi dakord me miratimin e procesverbaleve? Variantin të pandryshuar me propozimin.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Pro.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 28.02.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 14:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Medi Bici | (anëtar) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 7. Përfaqësues të USAID-it.*
- 8. Përfaqësuese e OSBE-së.*
- 9. Përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës e cila në fakt është çështja e tretë (*çështja nr. 3 sipas rendit të shpërndarë në mbledhjen plenare*). Shqyrtimi i projektvendimit “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Atëherë, sikurse jeni në dijeni, referuar nenit 33 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshillat janë ato organe që përcaktojnë gjykatat dhe prokuroritë e shkallës së parë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë si dhe trupën e magjistratëve udhëheqës, të cilët do të kryejnë vlerësimin etik dhe profesional të secilit kandidat për magjistrat, duke u bazuar në kriteret dhe në nivelet e vlerësimit të përcaktuar në ligj.

Në mbështetje të dispozitave të mësipërme si dhe me kërkesën, informacionin dhe materialet e përcjella nga Shkolla e Magjistraturës, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka

hartuar projekt-aktin e mësipërm për praktikat profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës.

Siç është parashtruar edhe në relacionin shoqërues, në këtë projektvendim është përcaktuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata Administrative e Shkollës së Parë Tiranë, të cilat do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë, profili gjyqtar, për vitin akademik 2017-2018, 2018-2019 dhe 2019-2020. Një përcaktim i tillë është bërë jo vetëm për faktin që tashmë këto dy gjykata ‘*de facto*’ është realizuar tërësisht praktika profesionale nga 10 kandidatët magjistratë të diplomuar në vitin 2018, por ndërsa është duke u realizuar ende praktika profesionale edhe për 15 kandidatët për magjistratë që diplomohen gjatë këtij viti në vazhdim.

Gjithashtu, ajo që është patur parasysh është që këto dy gjykata, praktikisht janë edhe dy gjykatat më të mëdha të vendit ku edhe kompetencat lëndore të të cilave përfshijnë një gamë të madhe/të gjerë mosmarrëveshjesh në të tre fushat kryesore, siç janë E drejta Civile, Administrative dhe Penale. Për më shumë informacion ia kaloj fjalën kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!!

Në vijim të fjalës së Kryetares, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar projektvendimin për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës. Ky është një detyrim i përcaktuar nga ligji nr. 96 i vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht neni 33 i tij. Në fakt, e gjithë kjo praktikë pune, pra sa i përket praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, duhet të kishte filluar që me hyrjen në fuqi të këtij ligji, që daton në nëntor të vitit 2016, sikundër edhe referuar përcaktimeve që ka bërë ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ligji nr. 115 i vitit 2016, sa i përket programit të formimit fillestar, në kuadër të Shkollës së Magjistraturës, ligj ky që ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2016. Në fakt, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk është krijuar pikërisht në këtë kohë, është krijuar vetëm në dhjetor të vitit 2018, ndërsa të dy ligjet, ligji i Shkollës së Magjistraturës që është inkorporuar brenda ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka pësuar ndryshime thelbësore sa i përket programit të formimit fillestar të kandidatëve magjistratë.

Ndryshe nga më parë, pra ndryshe nga ligji nr. 8136 i korrikut të vitit 1996 , i ndryshuar “Për Shkollën e Magjistraturës”, ku përcaktohej se programi fillestar i kandidatëve, ndër të tjera, përfshinte edhe një vit praktik aktiv në ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (periudha e stazhit profesional).

Ligji i ri i hyrë në fuqi, pra ligji 115/2016 që ka hyrë në fuqi në 17 dhjetor të vitit 2016 ka përcaktuar një mënyrë të ndryshme të programit të formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë ku referohet që ata duhet të realizojnë një vit praktik profesionale që do të organizohet sipas mënyrës dhe afateve të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ndërkohë, në këtë të fundit është neni 33, përcaktohet se Këshillat, pra përfshirë edhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, përcaktojnë gjykatat dhe prokuroritë e shkallës së parë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë; Po kështu, Këshillat caktojnë një trupë magjistratësh udhëheqës me një kohëzgjatje prej 3 vjetësh me të drejtë riemërimi; Po kështu përcaktohet se Këshilli cakton udhëheqës për secilin prej kandidatëve magjistratë, me qëllim që secili të përmbushë disa nga detyrimet që përcaktohet konkretisht në ligj dhe; në finale, magjistrati udhëheqës duhet të bëjë edhe një vlerësim etik dhe profesional të secilit kandidat magjistrat.

Ndërkohë, legjislacioni në fuqi, pra dy lidhet e sipërcituara, në dispozitat kalimtare nuk i ka dhënë këtë të drejtë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që ishte organi që vijonte të ishte ekzistent, pavarësisht se sipas konceptit dhe mënyrës së konceptimit të reformës në drejtësi, referuar dy ligjeve më lart, duhej të krijohet Këshilli i Lartë Gjyqësor, ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk është i dhënë kompetencë që të ushtrojë përgjegjësitë sipas nenit 33 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Në një ngërç të tillë, duket që shkolla, referuar korrespondencës që është pjesë e materialit të kësaj mbledhjeje, ka iniciuar, për të mos dështuar procesi i formimit fillestar të kandidatëve magjistratë, që ishin të vijim të studimeve të tyre, ka iniciuar një proces në bashkëpunim me kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kryetarin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për të mundësuar zhvillimin e praktikës profesionale referuar kuadrit të ri ligjor. Rezultojnë që të jenë trajnuar një

numër gjyqtarësh nga këto gjykata, por jo vetëm, por edhe nga gjykatat e tjera, në lidhje me pozicionin e udhëheqësit për kandidatët magjistratë. Po kështu është marrë edhe mendimi i këtyre dy kryetarëve të këtyre dy gjykatave sa i përket gjyqtarëve që mund të angazhoheshin për të ushtruar veprimtarinë e udhëheqësit për kandidatët magjistratë, sa i përket atyre që kishin filluar studimet në vitin akademik 2015-2016, që në vitin 2017, pra tashmë kur ligjet si më lart kishin hyrë në fuqi, duhet të zhvillonin stazhin profesional pranë një gjykate.

Rezulton që praktikisht shkolla të ketë arritur që të zhvillojë për studentët magjistratë stazhin profesional që përcaktohet nga ligji pranë këtyre dy gjykatave, që rezultojnë të jenë dy gjykatat më të mëdha në vend dhe në konsideratë edhe të kritereve që përcakton ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kishin numër të madh gjyqtarësh të disponueshëm, kishin infrastrukturën e nevojshme për të realizuar studentët kandidatë magjistratë praktikën profesionale, kishin edhe mundësi sipas lëndëve që ato përfshijnë, pra lëndët civile, penale dhe administrative, që kandidatët magjistratë të merrnin informacion dhe të adaptonin aftësitë e tyre gjatë praktikën profesionale në një numër shumë të madh dhe të shumëllojshëm ligjesh dhe çështjesh.

Praktikisht rezulton që për kandidatët për magjistratë që kanë përfunduar tashmë studimet në vitin 2018, të jetë realizuar stazhi profesional. Bashkëlidhur, shkolla ka sjellë edhe tabelën përkatëse ku këta kandidatë për magjistratë kanë ushtruar praktikën profesionale dhe gjyqtarët udhëheqës që i kanë ndjekur ato. Ndërkohë, edhe për studentët kandidatë për magjistratë që vijojnë studimet dhe që i kanë filluar ato gjatë vitit akademik 2016-2017, në korrik të vitit 2018 ka filluar praktika profesionale. Janë ezauruar tashmë dy periudhat e para katër mujore dhe ne jemi në momentin që duhet të caktojmë magjistratët gjyqtarë udhëheqës për periudhën e fundit dhe me të cilën përmbillet praktika profesionale për studentët që duhet të diplomohen këtë vit, pra në vitin 2019.

Duhet që shkolla, në bashkëpunim me dy kryetarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë (*Tiranë*), nën frymën e ligjit dhe përcaktimeve që ligji ka bërë, kanë arritur të përmbushin me sukses një nga detyrimet ligjore që ligji ka ngarkuar edhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, por që në mungesë të ngritjes së tij,

duket që është ezauruar tashmë vetëm nga Shkollë e Magjistraturës dhe dy kryetarët e dy gjykatave të përmendura më lart.

Jemi në kushtet që duhet të konsiderojmë miratimin e këtij procesi që tashmë ka ndodhur dhe në momentin që tashmë përfshihet Këshilli i Lartë Gjyqësor, të marrë masa që të përcaktojë këto dy gjykata për vijimin e procesit të praktikave profesionale, po kështu të përcaktojnë trupën e magjistratëve udhëheqës që duhet të vijnë praktikën profesionale studentët kandidatë për magjistratë për një periudhë 3-vjeçare (sepse ligji e përcakton një gjë të tillë). Gjithsesi, sa i përket trupës së magjistratëve, mund të thuhet që ne kemi propozuar që të miratohet e njëjta trupë, që në fakt ka realizuar deri më sot udhëheqjen në praktikat profesionale, por që nuk kemi asnjë pengesë ligjore që në një të ardhme, ndërsa shkolla duhet të përfshijë gjyqtarë magjistratë në trajnimet specifike profesionale për trajnerë si udhëheqës për kandidatët për magjistratë, të zgjerojmë këtë listë për praktikën profesionale për vitin në vijim, që i bie korrik 2019 – qershor 2020 dhe në atë rast, për çdo periudhë apo në të gjithë periudhën në vijim mund të konsiderojmë gjyqtarët edhe përtej listës që është pjesë e materialit të mbledhjes, që po e ritheksoj, janë të gjithë gjyqtarët që në fakt janë angazhuar deri më sot si udhëheqës për dy breza të kandidatëve për magjistratë.

Këto ishin pak a shumë ato që mund të thosha. Nëse ka ndonjë pyetje nga kolegët, mund t'i bëj një sqarim.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Ka ndonjë pyetje ndaj zotit Toska?

Brunilda Kadi: Pavarësisht se nga ana e kryetarit të Komisionit u shpjegua, thjesht për të qenë e qartë për Këshillin, a na lejon kjo vendimmarrje sot që neve, për fazën tjetër të mund të përfshijmë në listë edhe gjyqtarë të tjerë? Sepse përfshirja e këtyre gjyqtarëve në këtë listë, -siç edhe thatë ju/theksuat - është në fakt fakt që është bërë për shkak edhe të mungesës së Këshillit të Lartë Gjyqësor që e kishte këtë kompetencë, është fakt që këta magjistratë janë përfshirë në këtë proces sipas sugjerimeve të shkollës dhe kryetarëve përkatës të gjykatave?

Atëherë ne nuk na pengon që në fazën tjetër, në vitin tjetër shkollor, të përfshijmë në listë edhe magjistratë të tjerë.

Ilir Toska: Atëherë, në materialet që janë pjesë e praktikës për këtë pikë të rendit të ditës është e gjithë korrespondenca që shkolla ka zhvilluar me kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kryetarin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Shkolla, në një moment të caktuar kohor, pra me hyrjen në fuqi të këtyre ligjeve, në bashkëpunim me misionin EURALIUS, ka trajnuar një grup gjyqtarësh. Nga ana tjetër, për ta bërë efektive skemën e re, sipas ligjit të ri, pra për realizimin e praktikës profesionale, ka kërkuar bashkëpunim me kryetarët e dy gjykatave më të mëdha në vend (dy gjykatat që përmendëm lart), ku janë sugjeruar edhe disa gjyqtarë që nuk janë trajnuar në fakt nga shkolla deri në atë moment. Praktikisht, të gjithë këta janë përfshirë, të gjithë këta gjyqtarë të trajnuar dhe ata jo të trajnuar por të propozuar nga kryetarët respektivë të gjykatave, janë përfshirë në procesin e praktikës profesionale. Jemi para faktit të kryer kur kjo gjë ka ndodhur.

Nuk kemi asnjë pengesë ligjore që Këshilli të zgjerojë listën e magjistratëve, por duke konsideruar që ata duhet të trajnohen paraprakisht pranë shkollës si trajnerë udhëheqës.

Në pikën 3 të projektvendimit është përcaktuar që magjistratët udhëheqës sipas pikës 2 të këtij vendimi të angazhohen menjëherë për të ndjekur trajnimet vazhduese pranë Shkollës së Magjistraturës. Në kuadër të këtij trajnimi, mund të angazhohen edhe gjyqtarë të tjerë që preferojnë të marrin pjesë apo Këshilli mund të sugjeronte që të angazhoheshin në këtë lloj veprimtarie dhe të realizojnë këtë trajnim sepse është një nga kërkesat e ligjit që, magjistratët udhëheqës duhet ta kenë për t'u caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si magjistratë udhëheqës. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zoti Toro!

Alban Toro: Në vijim të asaj që përmendi kryetari. Është fakt që aktualisht, disa prej mentorëve nuk është se plotësojnë kriteret që kërkon ligja aktualisht, por jemi të detyruar duke qenë që ndodhemi përpara një fakti të kryer tashmë për t'i dhënë zgjidhje problemeve që ka shkaktuar kjo lloj situatë, të miratojmë atë listë mentorësh që janë aty. Në të ardhmen do të kërkonim që, ose do t'i sugjeroja Këshillit që këta mentorë (pra gjyqtarë), të futeshin në listën precedente për t'u vlerësuar sepse një nga kriteret është vlerësimi i tyre, për post faktit që t'i nënshtrohen edhe trajnimit. Janë disa veprime emergjente që nëse në të ardhmen duhet të miratojmë një listë mentorësh për katër mujorin tjetër. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit? Kemi ndonjë sugjerim konkret tjetër?

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Mund të shtojmë një pikë tek projektvendimi, të jetë pika 9, që ky vendim t'i dërgohet Shkollës së Magjistraturës, kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sikundër edhe magjistratëve gjyqtarë udhëheqës, pra ata që do të operojnë për vijimin e praktikës profesionale për periudhën e tretë, katër mujore të vitit akademik 2018-2019. Pra sugjerimi është të shënojmë si pikë 9: "9. Vendimi t'i dërgohet Shkollës së Magjistraturës, kryetarit...

Naureda Llagami: Ajo do jetë pika 9 sepse kur themi: "Ky vendim hyn në fuqi menjëherë" është pa pikë. Nuk vendoset pikë tek teknika legjislativë. Kështu që, ajo nuk ka pikë. Vetëm ajo pikë do kalojë tek pika 9 dhe do jetë shprehja e fundit. Okej?

Kam edhe një merak tjetër. Thjesht për ta saktësuar midis nesh.

Ju keni përdorur "të caktojë" dhe "miratojë" me slesh (caktojë/miratojë). Gjykoni që do i mbajmë të dyja?

Ilir Toska: Mund ta shpjegoj pse e kemi bërë kështu. Kemi zgjedhur një mënyrë të tillë sepse praktikisht në po miratojmë atë çka ka ndodhur, pra po ligjërojmë një veprimtari që tashmë ka ndodhur, duke konsideruar atë në përputhje me ligjin, ndërkohë po vijojmë të përmbushim edhe detyrimet tona ligjore, sipas përcaktimeve që ligji na ngarkon, që jemi detyruar të caktojë gjykatat, sikundër të caktojë edhe magjistratët gjyqtarë udhëheqës. Prandaj janë përdorur të dyja këto emërtesa, që të bëhet e qartë se çfarë jemi duke bërë praktikisht.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim, me gjithë propozimin e bërë nga kryetari i Komisionit për shtimin e pikës 9, me përmbajtjen e sipërcituar? Kalojmë projekt-aktin në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 28.02.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projekt-udhëzimit “Mbi pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare” të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 14:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Medi Bici** (anëtar)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 7. Përfaqësues të USAID-it.*
- 8. Përfaqësuese e OSBE-së.*
- 9. Përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projekt-udhëzimit “Mbi pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare” të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Vazhdojmë tek çështja e radhës që është shqyrtimi i projekt-udhëzimit “Mbi pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare” të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Ky Komision ka sjellë këtë propozim për miratim. Në relacionin shoqërues Komisioni thekson që në zbatim të ligjit 9877 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor...”, pra ligjit të mëparshëm i cili parashikonte shprehimisht: “Gjyqtari që kryen detyra të ngutshme në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare, përfiton shtesë page në masën 50 për qind të pagës së tij ditore”. Ndërkohë, një parashikim i tillë, me kuadrin e ri ligjor, nuk është reflektuar, pra në ligjin 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” ashtu dhe në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”. Për shkak të kësaj mungese gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë dhe ata të apelit nuk janë kompensuar financiarisht që nga 1 janar i vitit 2019.

Për më shumë informacion, fjalën ia jap kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, zonjës Lubonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Ju faleminderit, zonja Kryetare!

Ashtu siç edhe ju relatuat, miratimi i këtij Udhëzimi është i domosdoshëm për shkak se nga të gjitha gjykatat, kryesisht gjykata e shkallës së parë dhe e apelit në Republikën e Shqipërisë, janë shfaqur problematika për mënyrën sesi duhet të kompensohen gjyqtarët për punën që ata ushtrojnë ditët e pushimit javor apo të festave zyrtare. Mënyra e kompensimit të gjyqtarëve ka qenë e parashikuar shprehimisht në ligjin e mëparshëm, ndërkohë që aktualisht në ligjin “Për statusin...” gjen vetëm parashikim në nenin 11 ku parashikohen parimet e caktimit të pagës së magjistratit, ku veç parimit të pagës parashikohet që magjistrati ka të drejtën edhe të përfitimeve të tjera për shkak të kushteve, një nga të cilat është edhe përfitimi që ai merr për shkak të kushteve të veçanta të punës. Pikërisht është ky momenti ku ne jemi bazuar për hartimin e këtij projekt-udhëzimi, me qëllim që gjyqtarët, edhe për punët që ushtrojnë ditët e festave zyrtare apo të pushimit javor të kompensohen, por masa e kompensimit do të përcaktohet sipas Kodit të Punës i cili gjen zbatim në kushtet kur nuk rregullohet konkretisht nga ligji dhe neni 4 i Kodit të Punës lejon mënyrën e aplikimit edhe të këtij kodi. Parimi i përgjithshëm është që gjyqtari që ushtron funksionin në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare, do të marrë një shpërblym në masën e 50% të pagës së tij ditore.

Nxjerrja e udhëzimit është e nevojshme sepse nga 1 janari 2019, gjyqtarët, edhe pse kanë ushtruar funksion në këto ditë, nuk janë paguar. Problematika që ngrihej ka të bëjë më faktin që nëse gjyqtari do të paguhej vetëm nëse do të zhvillonte seanca gjyqësore në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare, apo thjesht ai duhet të ishte pjesë e listës së gatishmërisë së miratuar nga kryetari i gjykatës dhe duhet të merrte këtë përfitim, pavarësisht faktit nëse ai zhvillonte seanca gjyqësore apo jo.

Për të arritur në një udhëzim sa më të saktë dhe referuar parimeve për të cilat ligji parashikon mundësinë e këtij përfitimi financiar, ne i kemi kërkuar të gjitha gjykatave që të na japin një tabelë statistikore lidhur me çështjet që janë gjykuar ditët e festave zyrtare dhe pushimit javor, dhe bëhet fjalë vetëm për çështje të ngutshme, ato për të cilat ligji parashikon afatin e shqyrtimit nga 24 deri në 72 orë nga momenti i regjistrimit të

çështjes, bashkë me volumin në tërësi të çështjeve të gjykuara në këto gjykata. Tabela statistikore i bashkëngjitet relacionit. Siç mund të vini re edhe në tabelën statistikore rezulton që gjykatat që kanë numër më të vogël gjyqtarësh, që janë gjykatat 4 deri në 6 gjyqtarë, kanë gjykuar një numër shumë të vogël të çështjeve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare (bëhet fjalë vetëm për çështje të ngutshme), ndërkohë që këta gjyqtarë, nëse do të zbatoheshin parimi që duhet të kompensoheshin vetëm në bazë të listës së gatishmërisë, do të kishin një përfitim financiar që shkonte në një përfitim të përcaktuar 1 herë në muaj ose 1 herë në muaj e gjysmë dhe në këtë mënyrë, shpërblimi kthehej në një element përcaktues të pagës. Ndërkohë që gjyqtarët që gjykonin çështje pothuajse që kanë gjykuar nga 2 deri më shumë çështje në ditët e pushimit javor, këtë përfitim do ta kishin 1 herë në 6 muaj ose ndoshta edhe 1 herë në vit. Pra kishte një disproporcion shumë të madh midis punës që ofronte gjyqtari (kam parasysh seanca gjyqësore që zhvilloheshin) dhe masës së përfitimit.

Për këtë arsye, për të garantuar zbatimin e parimeve të parashikohet në ligj dhe për të garantuar zbatimin e trajtimit të barabartë të gjyqtarëve, kemi parashikuar në këtë udhëzim që të gjithë gjyqtarët e shkallës së parë dhe ata të apelit që gjykojnë çështje të ngutshme për të cilat duhet të vendoset nga 24-72 orë nga momenti i regjistrimit, do të përfitojnë kompensim financiar vetëm në rast se ata zhvillojnë seanca gjyqësore efektive, pra vetëm nëse ata gjykojnë në këto ditë pushimi.

Nuk është parë e nevojshme vendosja e një diferencimi midis trajtimit të gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë dhe gjyqtarëve të gjykatës së apelit, të cilët referuar statistikave, rezulton që vetëm 10% nga 90% të çështjeve i kanë gjykuar në ditë të tilla.

Nga ana tjetër, doja të sqaroja që pse kemi menduar që ky akt duhet të jetë organizuar ose duhet të jetë shkruar në formën e një udhëzimi. Në vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Profesional, ky akt në fakt përbën një akt kolektiv sepse lidhet me statusin e gjyqtarit. Përfitimet financiare në ligj, ashtu si dhe paga, janë elementë të statusit të gjyqtarit. Duke qenë se lidhen me statusin e gjyqtarit, duke qenë se i referohen një numri gjyqtarësh të përcaktuar, pra janë gjyqtarë të shkallës së parë dhe ata të apelit (jo gjyqtarët e Gjykatës së Lartë), duke qenë se edhe vendosin zgjidhjen

uniforme nga të gjitha gjykatave të një çështjeje të caktuar, ka natyrën e një akti kolektiv, i cili është udhëzim detyrues, pra nuk është udhëzim jo detyrues nga ato që parashikon ligji dhe është zgjedhur udhëzimi sepse uniformison zbatimin në ligj në të gjitha gjykatat. Nuk ka vullnet vendimmarrës për të zgjidhur një çështje ndryshe nga ana e Këshillit.

Kaq! Kush ka pyetje.

Edhe diçka tjetër. Pikërisht kjo që sapo thashë, duhet të reflektohet edhe në preambulën e projekt-udhëzimit, duke u saktësuar që është pikërisht neni 97, pika /b/ e ligjit që e detyron Këshillin për nxjerrjen e aktit nënligjor.

Edhe diçka tjetër. Për efektet financiare, duke qenë se Këshilli mund të miratojë edhe akte me fuqi prapa vepruese, në kushtet kur asnjë gjyqtar, nga 1 janari 2019 e në vazhdim, nuk është paguar për punën që ka ofruar për seancat gjyqësore që ai ka zhvilluar ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare, kemi vlerësuar që efektet financiare të këtij udhëzimi të fillojnë nga data 1 janar, atëherë kur ka filluar edhe skema e re e pagave për gjyqtarët.

Naureda Llagami: Ka ndonjë gjë për të diskutuar dhe shtuar? Po!

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Unë thjesht doja të bëja një pyetje për sa i përket pjesës së gjyqtarit të gjykatës së apelit. Dua të orientohem më tepër. Çfarë veprimesh të ngutshme mund të kryejë një gjyqtar i gjykatës së apelit, pra nga ato që parashikohen të kryhen brenda një afati 24 apo 72 orë?

Brikena Ukperaj: Gjyqtari i gjykatës së apelit, përgjithësisht, për çështjet e ngutshme, ka afatin 10-ditor, por ka vlerësime përgjimesh që duhet t'i kryejë brenda 24 orëve, ka edhe shuarjet e masave të sigurimit që duhet t'i kryejë brenda 48 orëve. Në qoftë se ka një ankim të një vendimi përgjimi - tani, nuk e kam nenin 224 – të gjykatës së shkallës së parë, kur është refuzuar për shembull përgjimi ose është lejuar, brenda 24 orëve, gjyqtari i apelit duhet të shprehet lidhur me përgjimin. Edhe për shuarjen e masës e ka afatin 48 orë. Supozojmë sikur do të vijë një kërkesë për shuarje mase ditën e premte në orën 16:30, gjyqtari i gjykatës së apelit ka afat 48 orë për ta shqyrtuar kërkesën. Mund ta shqyrtojë ditën e shtunë, mund ta shqyrtojë ditën e diel.

Medi Bici: Kisha edhe unë një pyetje.

Me gjyqtarët e gatshëm, për masat e sigurimit, që dalin ditën e shtunë dhe të diel, kur nuk vijnë masat, çfarë do bëhet?

Brikena Ukperaj: Atëherë, ajo çka kemi arritur ne në konkluzion është që, në qoftë se gjyqtari nuk zhvillon seancë gjyqësore, nuk e gëzon këtë përfitim financiar, për çka relatova më lart.

Medi Bici: Pra, lë shtëpinë, ikën nga Tirana në Dibër, që të jetë i gatshëm të shtunën dhe të dielën dhe nuk përfiton asnjë masë financiare?

Ilir Toska: Mendoj që nuk shkon në punë gjyqtari nëse nuk ka çështje. Kur ka çështje është i detyruar të shkojë. Nëse dihet që s'ka çështje, nuk...

Medi Bici: Si e merr këtë dijeni që s'ka çështje?

Ilir Toska: Fakti që s'ka çështje, e vë në dijeni sekretaria gjyqësore që ka çështje dhe duhet t'i japë dosjen. Nëse s'ka çështje, nuk ka pse të shkojë të paraqitet për asgjë.

Medi Bici: Masat e sigurimit merren vesh që ditën e premte.

Ilir Toska: Nëse vjen çështja ditën e shtunë, gjyqtari njoftohet dhe zhvillon seancën ditën e diel. Nëse çështja vjen ditën e premte, gjyqtari e vendos kur do e zhvillojë seancën, të shtunën apo të dielën. Pra gjyqtari e di paraprakisht nëse ka një çështje dhe kur është hapësira ligjore që ai duhet ta zhvillojë.

Marçela Shehu: Kisha edhe unë një pyetje.

Ju keni parashikuar në pikën 2 që gjyqtari do të kompensohet vetëm nëse gjykon çështje urgjente. Po nëse gjyqtari ushtron veprimtari të tjera që nuk lidhen vetëm me gjykimin, por me veprimtari administrative që lidhen me punët e gjyqtarit, të tilla si realizimi i njoftimeve, nuk është parashikuar nga ana juaj? Pra studion aktet e ardhura; vendosë të caktojë seancën gjyqësore duke urdhëruar sekretarinë që të realizojë vendimet përkatëse. Për këtë veprimtari nuk do të paguhet?

Brikena Ukperaj: Në qoftë se do të vazhdoni me këtë logjikë, unë e shpjegova. Do të kishim një disproporcion shumë të madh sepse çdo gjyqtar që është në javën e gatishmërisë mund të pretendonte që unë të shtunën do shkojë në gjykatë dhe do studioj dosjen, do ta lë seancën për të hënë. Kjo në fakt nuk do të ishte efektive sepse do ta kthente, nëse do ta përcaktonim kompensimin edhe për këtë punë, në elementë përcaktues të pagës dhe mjaftonte fakti që ai të ishte në listën e gatishmërisë, do ta merrte përfitimin.

Sqarojmë që sot kemi gjykata me 2 gjyqtarë dhe këto gjykata me 2-3 gjyqtarë kanë gjykuar për vitin 2018 një numër shumë të vogël çështjesh në ditët e pushimit javor dhe këta gjyqtarë, masa e kompensimit do t'i shkonte disa herë më e madhe, pra do të kishte një disproporcion. Mendoni, do të merrnin rreth 700 mijë lekë në muaj shtesë (të vjetra), edhe nëse nuk gjykonin fare çështje. Probabiliteti më i lartë është që nuk kanë gjykuar fare çështje. Dhe kjo do të sillte një disproporcion shumë të madh midis gjyqtarit që gjykon të shtunë-të diel një sasi mbi 70% të çështjeve, me gjyqtarin që nuk bën asnjë punë, në kuptimin që nuk gjykon çështje (jo se nuk bën punë). Prandaj dhe është parë për të patur një mënyrë të njëjtë trajtimi. Prandaj dhe është zgjedhur kjo mënyrë. Nuk kemi një kriter matës aktualisht. Nuk mund të bëjmë një kriter matës që, gjyqtari që do shkojë të studiojë çështjen, do të marrë këtë kompensim. Pastaj mos harrojmë që të shtunë të diel, gjyqtarët mund të shkojnë të studiojnë edhe dosjet e javës, jo vetëm dosjet e masave. Kështu që...

Marçela Shehu: Jo, unë po flisja kur ne na rezulton efektivisht që gjyqtari është në punë pikërisht për të marrë këtë lloj kërkesë, për të marrë këtë dosje, për të shqyrtuar aktet që lidhen me këtë dosje dhe për të kryer, për të ushtruar veprimtarinë e gjyqtarit që lidhet me këtë dosje. Pra nuk po flasim për rastet që gjyqtari do të shkojë në punë dhe do arsyetojë vendime të tjera që s'kanë lidhje me këtë rast konkret. Pra, për mua, do të ishte më e përshtatshme që nëse dokumentohet që gjyqtari jo vetëm ka gjykuar, por një ditë më përpara ka qenë në punë efektivisht, është njohur me dosjen, ka qenë ai që është prezantuar me dosjen (pra jo sekretari gjyqësor), ka realizuar veprimtarinë e tij, është njohur me dosjen, ka realizuar njoftimet, etj., etj., atëherë ai duhet të përfshihet në kompensim edhe kjo ditë. Pra unë jam dakord që mos të paguhet gjyqtarët vetëm duke qenë në listën e gatishmërisë, vetëm për këtë shkak, por ata të kompensohen dy ditë nëse ai rezulton të ketë qenë efektivisht për shkak të kësaj dosjeje në gjykatë.

Brikena Ukperaj: Nuk është parë kjo zgjidhje sepse njoftimet i bën sekretarja gjyqësore normalisht në gjykatë. Nëse vijnë masat e sigurimit edhe ditën e premtë, gjyqtari do dalë ditën e diel në punë ose do dalë ditë e shtunë në punë, pra do ta bëjë masën e sigurimit. Kështu që nuk mendoj që ka ndonjë ngërç në këtë rast. Do ta marrë përfitimin. Sepse të mendohet që do dali të shtunën për të caktuar një seancë gjyqësore

edhe pastaj do ta bëjë seancën gjyqësore të hënën dhe do marri përfitim vetëm për faktin që caktoi seancën gjyqësore? Nuk më duket që shkon në përputhje me qëllimin që ka përfitimi financiar për efekt të punës së ushtruar.

Fatmira Luli: Të bëj një propozim?

Naureda Llagami: Po, zoti Hallunaj!

Fatmira Luli: Mos është mirë që në këtë dispozitë të shtojmë edhe veprimet procedurale që kryen gjyqtari për gjykimin e çështjes dhe përfshihen edhe vendimi për kalimin e çështjes. Në mënyrë që, në qoftë se ai del të dielën dhe cakton çështjen ta gjykojë e zëmë të hënën, ka marrë masat edhe për njoftimin, janë veprime procedurale.

Naureda Llagami: Mund të jetë kjo një opsion.

Vazhdo zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Ne e kemi diskutuar gjatë grupit të punës, të Komisionit të Vlerësimit, është diskutuar gjatë dhe është diskutuar edhe me anëtarët e tjerë të Këshillit, në lidhje me këtë udhëzim. Dhe duke nisur edhe nga përvoja ime si, kam qenë edhe kryetar gjykate dhe një nga problematikat kryesore ka qenë edhe kjo, pra efektet e pagesës për ditët e pushimit apo festat zyrtare dhe gjithë ideja ishte... unë personalisht isha në fillim me mendimin që gjyqtari do të paguhet nëse kryen veprim. Çfarë do të thotë? –Duhet të dali me vendim. Si dhe, pjesën tjetër pastaj, që ai gjyqtari që është i gatshëm të shtunën dhe të dielën, personalisht unë isha me mendimin që duhet paguar, pasi ai ka programuar që ato dy ditë do jetë në dispozicion të gjykatës dhe pavarësisht nëse vjen apo ka për të kryer apo jo (por vetëm gjyqtari i gatshëm). Ndërsa, për sa i përket pjesës tjetër pastaj, nëse do paguhet një gjyqtar që kryen disa veprime administrative apo procedurale, jam kategorikisht kundër. U bashkova me pjesën e anëtarëve të tjerë të cilët edhe pas relatimit që është bërë edhe nga ish Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, ku është nxjerrë lista mbi pagesat dhe veprimet e kryera në fundjavë, në ditët e pushimit apo festat zyrtare, dhe u bashkova me pjesën, pra u tërhoqa nga ideja që të paguhej gjyqtari për ditët e gatishmërisë, pavarësisht nëse nuk kryen ndonjë veprim. U tërhoqa me idenë se e gjithë kjo sjell, duke parë faturën financiare dhe kryesisht kjo edhe për gjykatat e vogla, i bie që një gjyqtar (kur kemi gjykata me 3 gjyqtarë), i bie që të kemi një herë në tre javë një gjyqtar të gatshëm për

gryketa që kanë edhe dy gjyqtarë, që i bie të jetë për 1 muaj (15 ditë njëri, 15 ditë tjetri) dhe fatura financiare pastaj është shumë e lartë për gjykatën por bëhet edhe një element përcaktues i pagës së gjyqtarit. Pastaj i bie që një gjyqtar në një rreth të marri një pagë shumë më të lartë se një gjyqtar tjetër që gjykon apo nuk gjykon.

Unë personalisht jam me idenë që të shprehen tek pjesa, pra që të dali me vendim, pra të ketë vendim. Pse çfarë ka ndodhur? Ka ndodhur që kanë ardhur dy veprime për lejimin e përgjimit dhe duke patur afatin 48 orë me ligj dhe një gjyqtar e linte një përgjim të premtën dhe përgjimin tjetër të shtunën dhe ai paguhej për të dy ditët. Pra, themi që ishte një rast abuziv dhe për të shmangur këtë gjë dhe për të shmangur këtë pjesën tjetër që pastaj gjyqtari doli dhe unë u mora me njoftimet, -unë nuk e shoh që duhet të dali gjyqtari të paguhet nëse kryen njoftime apo... Unë jam tek pjesa që ‘ai ka dalë me vendim’, pra të paguhet për pjesën që ka dalë me vendim, pasi edhe nga ky raporti që është bërë...

(Një nga anëtarët ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)

Vendim për çështjen... ‘Miratimin e përgjimit’ apo ‘Vlerësimin e arrestit’. Pra vetëm të bëhet gjyqi. Se duhet të kemi parasysh që sipas materialit që është këtu që na është paraqitur, i takon që për dy ditët (e shtunë, e diel), gjyqtari i gatshëm i takon të marrë një shumë rreth 35 mijë lekë të reja shtesë.

(Një nga anëtarët ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)

Jo të asaj natyre pra.

Dhe e gjithë ideja është që të lihet pak edhe në diskrecion të kryetarit të gjykatës, se ka momente që abuzohet me këtë pjesën e pagesave të ditëve të shtuna dhe të diela dhe ditëve të pushimit. Ashtu siç thashë që është abuzive pjesa që nëse kanë ardhur... se po të jetë e tillë, mund të bëhet edhe një veprim i tillë që të premtën vjen përgjimi, të shtunën cakton datën që nesër do bëhet përgjimi dhe do paguhet për dy ditët.

(Një nga anëtarët ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)

Jo, jo, por mund të vijë edhe ditën e premtë, në orën 16:00.

(Një nga anëtarët ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)

Po! Dhe kur do e bëjë seancën gjyqësore?

Pra do dalë detyrimisht të shtunën ose të dielën.

Brikena Ukperaj: Edhe diçka tjetër, për të ndjekur logjikën.

Nuk e sqarova, por në relacion e kam parashikuar që për stafin administrativ, në fakt ligji ngarkon me vendim të Këshillit të Ministrave për të trajtuar këtë pjesë, prandaj nuk është pjesë e udhëzimit, për pjesën e administratës dhe për pjesën e punonjësve të gjykatës, që ushtrojnë në fakt edhe ata, se janë shërbime ndihmëse, në funksion të veprimtarisë gjyqësore. Madje për ata parashikohet ditë pushimi. Nuk parashikohet kompensim financiar.

Në qoftë se ne do ta zgjerim mënyrën e përfitimit financiar të gjyqtarëve që shkojnë të shtunën në gjykatë dhe kryejnë veprime procedurale, mos harrojmë që në këtë ngarkesë të madhe të gjyqtarëve, ne të shtunave dhe të dielave mund t'i gjejmë edhe nëpër zyra gjyqtarët duke arsyetuar vendime. Gjyqtarët, ndoshta për shkak të kohës shumë të shkurtër të zhvillimit të seancave, kohëzgjatjes 8 orë të ditës, të gjithë gjyqtarët sot, jam e bindur, vendimet e tyre i arsyetojnë ose pasdite ose fundjavave. Edhe ata do jenë të shtunë, të diel në punë, do kryejnë veprimtari procedurale, sepse po arsyetojnë vendimin. Dhe nuk mund të barazojmë gjyqtarin që shkon dhe cakton një seancë gjyqësore ose do të urdhërojë sekretaren të bëjë njoftimet, me gjyqtarin që do gjykojë atë ditë, sepse në qoftë se do t'i barazojmë, atëherë për shkak të trajtimit të barabartë, duhet të paguajmë edhe gjyqtarin që zbardh vendimin të shtunën dhe të dielën.

Për këtë arsye, në bazë të parimit të proporcionalitetit dhe për të garantuar trajtim të barabartë, vlerësuam të nevojshme që ky përfitim financiar, për çështje të veçanta, të jetë vetëm për gjyqtarët që gjykojnë. Me fjalën 'gjykim' do të thotë që zhvillojnë seancë gjyqësore ditët e pushimit javor ose të festës zyrtare. Sepse mund të jetë edhe një urdhër mbrojtjeje, i cili është i pamundur që të dalë me vendim atë ditë, prandaj përdorëm fjalën 'gjykon'. Mund ta shtyjë për të nesërmen sepse ka afat 48 orë; mund t'i duhet gjyqtarit që të thërrasë një punonjës policie për ta pyetur në seancë gjyqësore, prandaj është përdorur fjala 'gjykon' dhe jo fjala që duhet të dalë me vendim atë ditë.

Naureda Llagami: Zoti Qoku!

Maksim Qoku: Faleminderit, zonja Kryetare!

Unë në fakt do bëj një studim të përgjithshëm, një kundër relacion mbase.

Unë do desha që të tërhiqej si akt për koincidencën që nesër është takimi i kryetarëve të gjykatave dhe ne në mbledhjen e kaluar e prekëm si fenomen, dhe duke qenë që është nesër, mbase do ta nxisja mendimin dhe do merrnim një opinion të unifikuar të tyre në lidhje me qëndrimin që kanë mbajtur, që dëshirojnë të mbajnë dhe si e konceptojnë, të paktën dy pikat e ‘gatishmërisë’ dhe ‘veprimeve të ngutshme’. Megjithatë, këtë ta gjykojnë të gjithë anëtarët.

Për mua më duket që debati nuk është në brazë ligjore sepse në relacion, përveçse pikave që përmenden e gjithë logjika është logjike ekonomike. Dhe me analogji, siç ne e pësuam në Komisionin e Ligjeve që për efekt të parave u goditëm në strukturë dhe ne themi për efekt të parave sepse dikush abuzon apo nuk i kemi ato para, të paguajmë këtë apo atë. Çka do të thotë, shoh që cenohet Kushtetuta (në tërësi disa nene por neni 26 për punën e papaguar dhe që godet motivimin), shoh që goditen neni 91 i Kodit të Punës, që ai e thotë ... në punë normale, plus 50 dhe përveç faktit shoh edhe probleme me nenin 37/ç të ligjit 98 “Për pushtetin gjyqësor...” i cili e përmend gatishmërinë dhe thotë, kryetari i gjykatës cakton për çështjet e ngutshme.

I gjithë debati bëhet nëse midis parimit të shpërblimit të drejtë dhe për mua, parimit të shpërblimit të barabartë, kush do të prevalonte? Mjafton t’i referohem termit ‘punë e papaguar’ apo dhe atë që preku kolegu Medi Bici që tha ka edhe gjyqtarë që nuk janë vend banues në gjykatat ku ushtrojnë profesionin, çka do të thotë hoteli, udhëtimi, fjetja, ngrënia, telefona, e gjëra të tjera, konsumojnë pagën e tyre. Por nuk po hyj në këto elementë. Po them që për mua prevalon parimi i shpërblimit të drejtë sepse është ndryshe një gjykatës që e ka shtëpinë tek gjykata dhe është në Tiranë dhe është ndryshe një gjykatës që e ka në Kukës apo në Pukë.

E dyta, kam idenë që ngatërrohem pak në aspektin e faktit objektiv. Ne gjykatat e vogla i kemi në bazë të një dekreti, të një harte gjyqësore të mëparshme dhe nuk mund t’i ndëshkojmë ne gjykatësit e atyre gjykatave subjektivisht, për efektin se janë pak gjyqtarë dhe bëhen më shpesh të gatshëm. Ajo që më shqetëson tjetër është fakti që ne këtu bëjmë analizën e rregullit, atë çka ligji e ka parashikuar dhe tani që u prekën ato përjashtimet, ne nuk i parashikojmë sepse ne thamë, gjyqtarët luajnë, pra luajnë me ligjin, në kuptimin që marrin efekte përfituese artificialisht. Këtë po, duhet ta parashikojmë, por ky përbën

përrjashtime. Por çfarë dalin, kur dalin, çfarë bëjnë, çfarë duan të bëjnë, si tentojnë ta aplikojnë dhe kur dhe në çfarë kohe dhe momenti e aplikojnë. Kështu që, po të ikim nga rregulli dhe t'ia lejmë ligjit se e ka parashikuar, ne realizojmë edhe atë rregullin e përgjithshëm ose aksiomën që udhëzimi nuk mund të dalë mbi frymën e ligjit dhe gatishmërinë dhe parashikimi për pagesën e ka bërë ligji. Udhëzimi është modalitet dhe mënyra, kohë, vend dhe mbasë masë për punën që e bëjnë dhe si e bëjnë dhe aq sa e bëjnë, prandaj duhet të kemi vëmendje tek fakti që ne duhet të merremi në përmbajtjen e udhëzimit, pa kundërshtuar ligjin si akt normativ më i lartë.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh që ne po bëjmë hartën gjyqësore. Dhe duke qenë që ne tre muaj na ikën dhe tre muaj brenda afatit 6-mujor ne do duhet që të kompletojmë hartën gjyqësore, kam përshtypjen që ky vendim (*udhëzim*) do ketë edhe efekt të shkurtër zbatimi – udhëzim, më falni – sepse harta gjyqësore do t'i zgjidhë problemet e gjykatave të vogla, do përpiqet të analizojë numrin, çështjet, dhe do t'i grumbullojë dhe çka do të thotë që nuk do të kemi më atë disproporcionin e të qenit të gatshëm të njërit në gjykatë të vogël më shumë se në një gjykatë tjetër. Duke qenë që harta i zgjidh këto probleme, atëherë themi që mos të marrim një udhëzim afatshkurtër, ku të jetë më vonë i pazbatueshëm, por të kemi parasysh që të marrim në konsideratë në të ardhmen hartën gjyqësore.

Që ta mbyll, por duke mos dashur që analiza ekonomike (jo njëri merr më shumë e tjetri më pak) të bëhet element thelbësor i këtij relacioni, them që për sa gjyqtarë janë të gatshëm dhe janë në funksion të atyre veprimeve që quhen të gatshme dhe për sa normalisht nuk mund të bëjnë gjë tjetër, teorikisht edhe sikur ta kenë shtëpinë pranë gjykatës, duhet që të merret në konsideratë pagesa e tyre, qoftë nëse kryejnë ose jo veprime. Por, përjashtimisht kam thënë dhe jam që për veprime artificiale që kryhen për efekt përfitimi pagese, ne t'i shprehim qoftë edhe në pika të veçanta. Prandaj ose është mirë të tërhiqet dhe të punohet me kujdes duke futur të gjitha pikat e veçanta që kanë shqetësuar gjykatat dhe kjo na mundëson që nesër, meqë është takimi i kryetarëve të gjykatave, të marrim një vendim të unifikuar të tyre ose nuk e di, do shprehem kundër këtij udhëzimi.

Brikena Ukperaj: Të sqaroj pak, zoti Nënkyetar!

Atëherë, ky nuk është një udhëzim që zbatohet sot dhe vendosëm ne.

Problematikat kanë qenë sepse të gjithë kryetarët e gjykatave kanë zbatuar në mënyra të ndryshme Kodin e Punës dhe ligjin. Disa gjyqtarë paguheshin me javë gatishmërie edhe nëse nuk gjykonin asnjë masë sigurimi dhe këta gjyqtarë, referuar statistikave - i shikoni se cilat gjykata janë – dhe disa gjyqtarë paguheshin edhe pse bënë 20 seanca gjyqësore masa sigurimi të shtunë, të diel. Nuk matet kështu puna e gjyqtarit. Por nuk kemi kriter matës tjetër, e para. E dyta, ju referuat që kemi shkelur Kushtetutën, ligjin, por nuk lexuat asnjë dispozitë që kemi shkelur sepse po jua lexoj nenin 91 të Kodit të Punës se çfarë parashikon, thotë: “Orët shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompensohen me pushim ose pagë të paktën 50% më të madhe se orët shtesë”. Sigurisht që gjyqtari nuk mund të kompensohet me pushim sepse ai e planifikon vet veprimtarinë e tij gjyqësore dhe ne nuk mund të ndërhyjmë në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit. Ama, duhet të kompensohet për orët shtesë të punës. Parashikimi ligjor ekziston. Orë shtesë e punës, në qoftë se do t’i qëndrojmë kësaj, është edhe ajo ora që unë marrë për të arsyetuar vendimin sepse tetë orar-shi nuk më del sepse zhvilloj seanca gjyqësore që në 8:00 deri në 4:00. Prandaj për ditët e pushimit javor dhe për festat zyrtare u pa e arsyeshme që kjo orë shtesë e punës të konsiderohet orë efektive që ti bën seancën gjyqësore, sepse ndryshe nuk ka kriter matës të veprimtarisë së gjyqtarit. Do kishim gjyqtarë që do thoshim, po, unë dola të shtunën sepse të premtën nuk më doli koha që t’i planifikoj seancat dhe t’i vë në lëvizje çështjet dhe vura të gjithë çështjet në lëvizje.

Edhe diçka tjetër, qëllimi i kësaj dispozite dhe i këtij udhëzimi dhe i ligjit për përfitime të veçanta ka të bëjë me kushtet e veçanta të punës, nuk ka të bëjë me gjithë veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit dhe nuk ka të bëjë as me largësinë e gjyqtarit, as me katin nëse gjyqtari e ka shtëpinë tek gjykata apo e ka shtëpinë në Tiranë.

Jo, thamë që gjyqtarët e gjykatave që janë më pak gjyqtarë, rezulton që përfitimi që ata marrin shkon në elementë përcaktues të pagës, çdo muaj do të marrin edhe gjysmë page shtesë, pavarësisht gjykojnë apo s’gjykojnë çështje të ngutshme. Kjo ishte e gjithë logjika. Megjithatë, unë propozoj që t’i hedhim të dy propozimet në votim. Nuk mendoj që janë kushtet për shtyrje sepse ne jemi konsultuar edhe me kryetarët e gjykatave dhe e

gjithë problematika e tyre qëndron këtu. Do paguajmë gjyqtarët sipas javës së gatishmërisë apo do t'i paguajmë sipas seancave efektive që ata bëjnë në ditët e pushimit zyrtar. E hedhim, nëse e doni kështu. Nëse jeni për javën e gatishmërisë.

Maksim Qoku: Të saktësohem unë.

Jam për pagesën e javës së gatishmërisë dhe pastaj ka kryer brenda ose jo veprime të ngutshme. Të paguhet java e gatishmërisë, pra gjyqtarët që janë... Pavarësisht punës, natyrisht.

Naureda Llagami: Në fakt, kjo bie ndesh edhe me pjesën e stafit administrativ. Domethënë, në qoftë se ne do jemi feir (*fair – të ndershëm/të paanshëm*) se është i njëjti Kod Pune që zbatohet edhe për gjyqtarët edhe për stafin administrativ. Për stafin administrativ do themi, -jo, i japim ditë pushim.

Një sekondë, si po aplikohet? Hajde të shohim aplikimin.

Për stafin administrativ, e dimë vetë, nuk ia japim dhe rri ai jashtë orarit.

Për veten tonë ne gjyqtarët, ne themi, -Jo, kemi lodhje pune dhe ne do ta justifikojmë.

Prandaj nëse ne bëjmë kujdes sepse do vijmë edhe për rregullimin e stafit administrativ sepse ajo VKM-ja që referohet nuk do jetë më për nëpunësin gjyqësor, do jetë vetëm për nëpunësin administrativ, për nëpunësin e administratës publike dhe jo për gjyqësorin. Kështu që, hajde bëhemi racional tek pjesa çfarë do quajmë orë pune dhe kush do jetë orë efektive pune. Sepse nëse vejmë si bazë ligjore Kodin e Punës, ky lloj Kod Pune nesër-pasnesër do na zbatohet edhe për orët tona këtu që konsumojmë, edhe për orët e stafit administrativ që asiston gjyqtarin. Kështu që, me kujdes kur ne i marrim vendimmarrjet tona.

Sa për pjesën e konsultimit të projekt-aktit, të paktën me dijeninë time, nga kryetarja e Komisionit, projekt-akti ka 3 javë që po konsultohet. Pra e gjej të pavend që ne nesër të harxhojmë kohë lidhur me pjesën e konsultimit, ku ne komplet kontributin që kemi hartuar këtu, ka qenë pjesë e konsultimit në mënyrë të vazhdueshme me kryetarët e gjykatave.

Lidhur me zgjidhjen opsionale a do kemi vendimmarrje, a s'do kemi vendimmarrje, a do kemi veprime, a do kemi gjykim, -këtë hajde e diskutojmë sepse kjo është pjesë dhe ne jemi të gjithë këtu dhe ne mund ta vlerësojmë këtë.

Po, zonja...!

Marçela Shehu: Atëherë, unë propozoj që në pikën 2 të bëjmë një ndryshim, duke përfshirë që gjyqtari të kompensohet financiarisht në rastet kur ushtron veprimtari gjyqësore dhe veprime të tjera procedurale (pra të gjejmë termin si ta mendoni më të përshtatshëm), por duke përfshirë edhe ditët kur gjyqtari, për shkak të kësaj çështjeje, do të jetë efektivisht në punë. Unë nuk mund ta pranoj që ta përmend këtu që ka gjyqtarë që abuzojnë me këtë lloj përfitimi. Pra nuk mund të mendoj që gjyqtari, të cilit shteti i ka besuar atë detyrë aq të rëndësishme, ne të diskutojmë që me këtë pjesë gjyqtarët luajnë apo përfitojnë. Duket jo e përshtatshme për të bërë një koment të tillë.

Brikena Ukperaj: Atëherë, veprimet procedurale Marçela, vetëm për efekt të javës së gatishmërisë?

Marçela Shehu: Po! Po! Vetëm për javën e gatishmërisë.

Jo veprime procedurale të çdo lloj natyre.

Brikena Ukperaj: Dhe kjo besoj është vetëm për gjyqtarët e shkallës së parë, jo për apelin. Domethënë të hidhet në votim nëse gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë do të kompensohet financiarisht nëse i duhet të gjykojë brenda 24 orëve ose 72 orëve ose vetëm nëse është në javën e gatishmërisë. Kaq.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Mirë atëherë, po vazhdoj edhe unë të jap opinionin tim. Mendoj që projekti që ka sjellë Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale është korrekt. Nuk gjej asnjë cenim të Kushtetutës dhe as të ligjit. Fjala 'gatishmëri' nuk është punë. Fjala 'gatishmëri' tregon një pozicion të caktuar të gjyqtarit që mund të angazhohet në punë nëse do ta lypë nevoja.

Sa i përket veprimeve procedurale, unë nuk e di se kush janë veprimet procedurale, përveç faktit që të lejë seancën gjyqësore dhe të urdhërojë sekretarinë që të bëjë njoftimet. Këtu nuk do as angazhim, as ndonjë punë, për vetë faktin që mund të

njoftohet sekretaria që të bëjë këto dy veprime. Punë efektive është të bësh gjyq dhe të shkruash vendime. Kjo është puna e gjyqtarit. Nuk di ndonjë punë tjetër.

Marçela Shehu: Nëse kemi një kërkesë për shqyrtim mase sigurimi gjyqtari duhet të njihet paraprakisht me aktet, duhet të njihet paraprakisht me dosjen dhe nuk mund të shkojë gjyqtari nga e premtja në të dielën direkt në punë me dosjen përpara dhe të bëjë gjykimin.

Ilir Toska: E kuptoj! Por fakti që duhet të njihet dhe të bëjë gjyqin, nuk do të thotë që do 1 javë të shqyrtojë çështjen dhe 1 javë të bëjë gjyqin.

Marçela Shehu: Nuk po flasim për 1 javë. Po flasim 1 ditë të shtunë që ai do dalë në gjykatë, do caktojë seancën, do realizojë njoftimet, do të njihet me aktet dhe të dielën do të jetë i gatshëm për të zhvilluar gjykimin.

Ilir Toska: Më thuaj një opion se sa kohë do të bësh të gjithë këtë, që të kuptoj që brenda 1 dite nuk ndodhin të gjitha këto gjëra dhe u dashkan 3 ditë të ndodhin.

Marçela Shehu: Unë nuk e di sa kohë mund të ndodhi kjo, se kjo është relative në varësi të secilit.

Ilir Toska: Je duke propozuar që, po bën një veprim, thjesht po lë një datë. Ky është veprimi. Fakti që do njihem është pjesë e punës, e angazhimit në punë, që duhet të studiojë materialet, duhet të bëjë gjyqin dhe të marrë vendimin. Dhe nëse nuk i bëj dot brenda ditës, një masë sigurimi, të gjitha këto gjëra, unë nuk e di se dashka 3 ditë të ndodhkan.

Naureda Llagami: Kjo është çështje që do kalojë në votim ne fakt, propozimi i zonjës Shehu. Po!

Fatmira Luli: Kisha një propozim konkret.

Atëherë, gjyqtari i shkallës së parë kryen veprime procedurale për çështje që regjistrohen në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare, dhe vazhdon pastaj, kompensohet, ose gjykon çështje urgjente për të cilat dispozita... domethënë shtohet vetëm fjala 'kryen veprime procedurale për çështjet që regjistrohen në gjykatë në këto ditë pushimi të festave'. Dhe këto janë veprime që duhet të nxjerri vendimin, të studiojë dosjen (veprime procedurale të tilla).

Brikena Ukperaj: Mund të hedhim në votim këtë propozim që kemi bërë ne, sepse po dalim edhe nga mënyra e procedimit. Në qoftë se nuk merr vota ky udhëzim, atëherë secili nga ne ka të drejtë të...

Brunilda Kadi: Okej, unë jam dakord me atë që thotë Brikena për ta hedhur në... por duke qenë se unë jam anëtare e Komisionit që vjen me propozim, e shoh të nevojshme të shpjegoj diçka paraprakisht.

Atëherë, fillimisht në këtë debat, siç edhe u tha nga kolegët, kjo është konsultuar gjerësisht nga të gjithë anëtarët. Nuk është një vendim kaq i thjeshtë sepse ka të bëjë me një aspekt shumë të rëndësishëm. Edhe unë fillimisht kam qenë totalisht kundër dhe isha me atë diskutimin që bëri zoti Qoku. Më pas, nga informacione të tjera që mori debati që u zhvillua, me sforcuarje erdha tek vendimi unanim i Komisionit. Por duke dëgjuar sot përsëri diskutimet unë vlerësoj që të kthehem përsëri tek pozicioni fillestar. Pra edhe unë i bashkohem diskutimit që bëri zoti Qoku.

Në lidhje me diskutimin tjetër që u bë dhe qasjet që duhet të kemi me vendimin e Këshillit të Ministrave për administratën, unë mendoj që këtë diferencë e ka bërë në mënyrë të qartë ligji dhe Kodi i Punës. Se pse nuk i jepet gjyqtarëve kompensim, kjo është e qartë, për shkak të natyrës. Sepse gjyqtari nuk mund të mungojë në detyrë kur të ketë ai dëshirë dhe është e vështirë që ai të kompensojë ditën që ka qenë pushim me një ditë tjetër, sepse në ditët e tjera ai ka planifikuar gjyqe, gjykatën e cenon, etj., etj. Diferenca qartësisht është bërë nga ligji. Për më tepër, nuk mund të krahasohet puna, përgjegjshmëria, përgjegjësia, stresi që ka gjyqtari me administratën. Sepse gjyqtari i gatshëm, ata që janë gjyqtarë e dinë shumë mirë se çfarë stresi është të jesh në fazën dhe në ditët e gatishmërisë, se nuk ka vetëm punën teknike, që shkon aty dhe hyn në seancë e dole. Procesi i vendimmarrjes, i shqyrtimit është një proces që vetëm ata që e kanë bërë e dinë se çfarë do të thotë dhe nuk krahasohet me punën e sekretares që bën thjesht një veprim teknik, vjen në sekondë, bën njoftimet, mban procesverbalin. Kështu që s'ka vend për krahasime.

Tani, sa i përket disproporcionit që krijohet tek pjesa e pagës, e punës efektive, atëherë, përveçse ligji përmend termin 'gatishmëri' dhe kur ti thua 'gatishmëri', do të thotë që ti je gjithë kohës i gatshëm. E përmendi edhe kolegu, Dritani, që edhe ai në fillim

e ka pasur këtë qasje sepse një gjyqtar që është i gatshëm nuk mundet të bëjë plane dhe të ketë një fundjavë normale si kolegët e tjerë sepse ai duhet të jetë në dispozicion. Kjo mjafton për t'iu cenuar dhe për t'u kompensuar. Dhe nga ana tjetër, doja të shtoja edhe diçka, thjesht në vazhden e atyre që u thanë këtu, është e vërtetë sepse unë vetë personalisht kam qenë gjyqtare në gjykatë relativisht të madhe ose edhe të vogël në krahasim me Tiranën, ku kishte javë që ti nuk bëje fare masa, kam qenë edhe 7 vjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku ti brenda ditës bën edhe 20 seanca. Është e vërtetë që nuk mund të krahasohet. Por është një fakt që ne asnjëri nuk mund ta mohojmë që ekziston, se ne nuk kemi parë ndonjë rast që gjyqtarët që rrinë në rrethe “rehat” (po e them në thonjëza), të kërkojnë të rrinë aty dhe gjyqtarët e Tiranës, e gjykatave të mëdha, të kërkojnë të shkojnë në rrethe të vogla meqë qenka rehat. Diçka ndodh, të gjithë ata që janë gjyqtarë në gjykatat e rretheve të mëdha, sidomos të Tiranës, nuk bëjnë ndonjëherë kërkesë të shkojnë nëpër rrethe meqë qenka komode puna në rrethe. Kështu që, unë sugjeroj që edhe ky është një argument që ky të quhet një shpërblim i drejtë, ndoshta mund ta quajmë edhe të barabartë sepse kompensojnë disa gjëra të tjera.

Kështu që unë sugjeroj të hidhet në propozim ajo çfarë propozoi Maksi, pra thjesht mjafton të jetë i gatshëm. Sepse ka edhe një problem tjetër, meqë mora fjalën ta them. Duke vendosur fjalën ‘gjykon’ apo ‘bën veprime’, do jetë e vështirë për t'u interpretuar sepse kush do ta interpretojë këtë fjalën? Gjykon ajo punonjësja e financës, gjyqtari ka bërë seancë, ka bërë vendim, ka bërë vendim caktim seance, ka shqyrtuar çështjen? Por çfarë ndodh në një rast kur ai futet në 8:00 të mëngjesit, ditën e shtunë, në një masë sigurimi dhe i shkon deri të nesërmen seanca, nuk merr dot atë ditë vendim, do ta marrë ditën tjetër vendimin... Jo pra, se u sugjerua këtu të bëhet kur merr vendim sepse mund të abuzohet. Nuk mund të ecim me idenë që gjyqtarët abuzojnë dhe jam dakord me atë që tha Marçela. Nuk mund të ecim me këtë për të bërë aktin. Se po flasim për gjyqtarët tani. Nuk abuzojnë gjyqtarët. Në qoftë se ka dikush që e bën këtë gjë, atëherë është përtej ligjit. Është shpërdorim detyre. Është më shumë sesa aq, në qoftë se abuzon. Kështu që edhe termi që doni të vendosni ‘gjykon’, ‘bën veprime procedurale’, do jetë e vështirë për t'u interpretuar nga ata që do ta zbatojnë këtë udhëzimin. Që nuk do jetë

kryetari i gjykatës në cilësinë e një gjyqtari por do jetë kryetari i gjykatës në cilësinë e një administratori. Kështu që shikojeni edhe këtë.

Naureda Llagami: Një sekondë, sa të sqaroj, se ngaqë na e përmendi administratën. Kisha vetëm thjesht për t'ju sjellë në vëmendje që ligji i posaçëm nuk të parashikon si do t'i bësh ato kompensime dhe i je referuar Kodit të Punës. Po shkove tek Kodi i Punës, më vjen keq, diferenca midis punës së administratës dhe punës së gjyqtarit, unë e mirëkuptoj shumë mirë vështirësitë që ka puna, është tek niveli i pagës e dashur. Kështu që, për sa kohë kemi një nivel page të ndryshëm, por rregullat janë të njëjta. Po dole ditë pushimi të punosh, si për gjyqtarin dhe për administratën, do marrësh o orë pushimi shtesë, o ditë pushimi ose do marrësh 50%. Sekretarja, duke qenë se ka ... të vogël, do marri në proporcion. Këtu është diferenca e lodhjes së gjyqtarit, tek niveli i pagës.

Tani, lidhur me pjesën, që mos ta zgjasim më këtë diskutim, unë propozoj që ne të hedhim në votim atë produkt që ka sjellë Komisioni. Më pas, nëse nuk kalon vendimmarrja për këtë, e hapim diskutimin për formulime konkrete. Dakord?

Dritan Hallunaj: Shumë shkurt.

Edhe një herë. Asnjëri nuk tha që nuk do të paguhen gjyqtarët, -se u tha këtu që do shkelet Kushtetuta, për punën e papaguar. Asnjë nuk tha që abuzojnë gjyqtarët, ashtu si u transmetua, -se nuk tha kush që abuzojnë gjyqtarët në këtë pjesë. Por ne duhet të bëjmë kujdes dhe unë mbështes variantin e parë, e thashë edhe përpara, është diskutuar disa herë, e kemi diskutuar këtë variant, dhe unë jam tërhequr nga pjesa që mos të paguhen ditët e shtuna dhe të diela ata që janë të gatshëm. Duhet të bëjmë kujdes gjithmonë, që shpërblimi i marrë të mos jetë element përcaktues i pagës, se nëse ne do të kemi një gjyqtar që paguhet, po themi ne, i kanë rënë dosjet (po marrë gjykatën e krimeve të rënda) që ka përgjime që janë masë me e madhe, numra shumë më të mëdhenj, dhe i ka rënë që të jetë çdo fundjavë dhe çdo ditë të një muaji i bie të punojë dhe atëherë paga që do marri ai del më i madh shpërblimi sesa paga që ai ka realisht dhe për këtë nuk lejohet, është ndalim. Ai paguhet në një masë të caktuar dhe nëse ti ke bërë, po themi ne, edhe 10 ditë gatishmëri (ditë pushimi), nuk paguan njeri për atë pjesë. Se gjithmonë ka një

proporcion të drejtë midis shpërblimit të marrë dhe... që mos të kalojë pra, mos të jetë element përcaktues i pagës. Kaq! Faleminderit!

Naureda Llagami: Kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Kundër, për arsyetimin që dhashë më sipër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër, vetëm me ndryshimin që propozova.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Jam pjesërisht kundër dhe do ta shpjegoj votën time. Gjyqtari i gatshëm shtunë dhe të diel, gjyqtari i shkallës së parë, duhet të paguhet, pavarësisht bëri apo s'bëri seancë.

Për këtë e thashë pra, jam kundër pjesërisht.

Brikena Ukperaj: Nuk e lejon ligji. Kundër ose pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë akti miratohet sipas propozimit të Komisionit me 6 vota pro dhe 5 kundër.

(Zonja Kadi largohet nga salla e mbledhjes dhe nuk merr më pjesë në zhvillimin e saj.)

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 28.02.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit në datën 15.02.2019, të gjyqtarit {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 14:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj pike anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja **Brunilda Kadi**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.**
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.**
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.**
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të EURALIUS-it.**
- 7. Përfaqësues të USAID-it.**
- 8. Përfaqësuese e OSBE-së.**
- 9. Përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit.**

RENDI I DITËS:

4. Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit në datën 15.02.2019, të gjyqtarit {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër.

Atëherë, çështja tjetër e rendit të ditës është: Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, të gjyqtarit {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, {...}, ka një karrierë 34-vjeçare në gjyqësor, i emëruar fillimisht në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Skrapar, më 17.02.1986 dhe më pas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendim të ish-KLD-së nr. 7, datë 24.01.1998.

Nga dokumentacioni që disponon, Drejtoria e Administratës dhe Financës, pranë Këshillit, vërehet se ky gjyqtar, {...}, sipas certifikatës së lindjes, është i datëlindjes 15.02.1954, dhe më datë 15.02.2019 mbush moshën 65 vjeç, moshë e cila konsiderohet si moshë e daljes në pension, duke iu referuar ligjit 7703 të '93 "Për sigurimet shoqërore", i ndryshuar. Për më shumë informacion, fjalën po ia kaloj kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, zoti Toska.

Ilir Toska: Këtë pjesë të rendit të ditës do ta relatojë anëtarja e Komisionit, Marçela.

Naureda Llagami: Atëherë, ia kalojmë fjalën relatueses, zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, zonja Kryetare!

Ashtu siç deklaruar edhe ju, Komisioni përkatës, pra i zhvillimit dhe karrierës, ka përgatitur relacionin përkatës dhe projektvendimin për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës për pension, të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, zotit {...}.

Bazuar në nenin 64 të ligjit për statusin e magjistratit, një nga rastet kur merr fund, pra mbaron statusi i magjistratit është pikërisht edhe rasti kur magjistrati mbush moshën e tij për të dalë në pension. Ka rezultuar nga dokumentacioni që disponon Drejtoria e Administratës dhe e Financës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, se zoti {...} është emëruar në detyrë më 17.02.1986, fillimisht në Gjykatën e Rrethit Skrapar dhe më pas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës më datë 24.01.1998.

Referuar akteve që lidhen me certifikatën e lindjes, rezulton se ai është i datëlindjes 15.02.1954 dhe më datë 15.02.2019 zoti {...} ka mbushur moshën 65 vjeç, moshë e cila konsiderohet si moshë e daljes në pension referuar ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore", i ndryshuar.

Ajo që vlen për t'u theksuar është që në ndryshim nga praktika e deritanishme apo edhe nga ligji i mëparshëm, ku mosha e daljes në pension për magjistratin/për gjyqtarin ishte e përcaktuar, ishte mosha 65 vjeç, në Kushtetutë por as edhe në ligjin aktual me nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" nuk është caktuar mosha e pensionit për gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit. Në ligjin "Për statusin..." është parashikuar mosha e daljes në pension për anëtarin e Gjykatës së Lartë, për Prokurorin e

Përgjithshëm, është bërë një parashikim edhe për pensionin e parakohshëm, moshë 60 vjeç, ndërsa moshë për dalje në pension të gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit nuk është përcaktuar.

Gjithashtu referojmë që pika 5 e nenit 64 të ligjit 96/2016 është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Gjithsesi, Këshilli çmon se bazuar në parashikimet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese i cili shfuqizoi pikërisht këtë dispozitë, në referim të ligjit “Për sigurimet shoqërore” ku parashikohet që moshë e daljes në pension për burrat është moshë 65 vjeç, pavarësisht se kjo, sipas Gjykatës Kushtetuese, është një situatë diskriminuese për gjyqtaret femra, por kjo i bie që do të jetë pjesë e një amendimi ligjor në të ardhmen, Këshilli, sugjeron/paraqet projektvendimin përkatës, bazuar në nenin 64 të ligjit “Për statusin...” si edhe në ligjin “Për sigurimet shoqërore”, paraqet përpara jush projektvendimin për të konstatuar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës për pension më datë 15.02.2019, të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor (Durrës), {...}.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Atëherë, të pranishëm në këtë votim janë të gjithë anëtarët, përveç zonjës Kadi, e cila për arsye personale u shkëput nga mbledhja. Megjithatë, ne mund ta vazhdojmë sepse kuorumi është.

Kalojmë projekt-aktin në votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, akti u miratua sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës. Kështu, Këshilli vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, të zotit {...}.

Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës.

Edhe çështja tjetër ka të bëjë prapë me...

Po, atëherë, ky vendim hyn në fuqi në datën e sotshme, më datë 28.02.2019, që përkon me datën e fundit të muajit.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 28.02.2019)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit në datën 26.02.2019, të gjyqtarit {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 14:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj pike anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja **Brunilda Kadi**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.**
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.**
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.**
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të EURALIUS-it.**
- 7. Përfaqësues të USAID-it.**
- 8. Përfaqësuese e OSBE-së.**
- 9. Përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit.**

RENDI I DITËS:

5. Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit në datën 26.02.2019, të gjyqtarit {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila është edhe kjo një projekt-akt që ka të bëjë me deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarit {...} për shkak të mbushjes së moshës së pensionit në datën 26.02.2019, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Edhe në rastin konkret është verifikuar që kryetari i kësaj gjykate, {...}, i emëruar në këtë detyrë me vendim nr. 34, datë 11.04.2014 nga KLD. Ka një karrierë 34-vjeçare në gjyqësor. Është emëruar në Gjykatën e Dibrës me një vendim të KLD-së nr. 8, datë 30.08.1996. Nga dokumentacioni që disponon Drejtoria e Administratës dhe Financës vërehet se ky gjyqtar, sipas certifikatës së lindjes, është i

datëlindjes 26.02.1954 dhe më datë 26.02.2019 ka mbushur moshën 65 vjeç, moshë e cila konsiderohet si moshë e daljes në pension, edhe referuar ligjit “Për sigurimet shoqërore”.

Doja t’ju informoja që lidhur me administrimin e kësaj gjykate, jo më larg se dje janë bërë edhe zgjedhjet për zëvendëskryetar, kështu që deklarimi apo jo i mandatit, të përfundimit të statusit të këtij gjyqtari nuk na pengon vazhdimësinë e menaxhimit të Gjykatës së Rrethit Dibër.

Për më shumë detaje fjalën ia jap relatorit të projekt-aktit që është zonja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, zonja Kryetare!

Edhe për zotin {...}, gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër vlen e njëjta logjikë juridike dhe i njëjti parashtrim faktesh. Rezulton nga aktet që disponon Drejtoria e Administratës dhe Financës që zoti {...} është i datëlindjes 26.02.1954 dhe më 26.02.2019 zoti {...} ka mbushur moshën e daljes në pension duke iu referuar ligjit 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore”.

Ashtu sikurse e cituam edhe për zotin {...}, ligji aktual 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” nuk e ka të përcaktuar qartë moshën e daljes në pension të gjyqtarëve, por Komisioni i është referuar ligjit të mëparshëm, i është referuar ligjit “Për sigurimet shoqërore” 7703, i cili përcakton pikërisht moshën 65 vjeç, moshë për daljen në pension të gjyqtarëve meshkuj, pavarësisht, ashtu sikurse e thashë, kjo do të jetë një pjesë e rishikimit të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve” sepse përbën një pikë, siç ka thënë edhe Gjykata Kushtetuese, diskriminuese për gjyqtaret femra.

Në këto kushte, ky Komision propozon që Këshilli të miratojë vendimin përkatës duke deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës për pension më datë 26.02.2019 të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, zoti {...}.
Ju faleminderit!

Naureda Llagami: E hedhim në votim projekt-aktin e propozuar nga Komisioni sipas relacionit dhe projektvendimit?

Maksim Qoku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës për pension më datë 26.02.2019, të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, {...}. Ky vendim hyn në fuqi më datë 28.02.2019.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 28.02.2019)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr. 35, datë 19.02.2019 “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 14:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj pike anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja **Brunilda Kadi**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.**
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.**
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.**
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.**
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.**
- 6. Përfaqësues të USAID-it.**
- 7. Përfaqësuese e OSBE-së.**
- 8. Përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr. 35, datë 19.02.2019 “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Vazhdojmë me çështjet e tjera të rendit të ditës.

Sikurse ia u sqarova që në fillim, çështjen që e kishim të renditur në pikën 2, po e kalojmë tani. Lidhur me shqyrtimin e projektvendimit për një shtesë në vendimin nr. 35, datë 19.02.2019 “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, jeni vënë në dijeni që në mbledhjen e datës 19 shkurt 2019, me vendimin nr. 35, Këshilli trajtoi kërkesat e ardhura nga kryetarët e gjykatave dhe nëpërmjet procedurës së shortit caktoi gjyqtarët për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo që ushtrojnë funksionin. Për shkak të numrit të madh

të kërkesave të trajtuara gjatë asaj mbledhjeje, rreth 180 kërkesa, si dhe procedurës së shortit të organizuar për herë të parë, për dy kërkesa, ndonëse ishte përgatitur relacioni nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nuk është realizuar procedura e shortit.

Për më shumë informacion, fjalën po ia kaloj kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, kemi përgatitur një relacion shtesë për faktin se gjatë procedurave të shortit për caktim të çështjeve gjyqësore të veçanta, sa i përket Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, në mbledhjen e datës 19 shkurt 2019 është ometuar për t'u bërë shorti për dy çështje gjyqësore të veçanta. Është bërë shortimi për 5 çështje, ndërsa për 2 çështje është ometuar, si duket nga ngarkesa, pika e fundit e shortit për këtë gjykatë nuk është realizuar. U konstatua mbas përfundimit të mbledhjes, në momentin e zbardhjes së vendimit dhe jemi detyruar të paraqesim një relacion shtesë, që vendimi nr. 35 i datës 19 shkurt 2019 të shtohet duke përfshirë edhe caktimin për dy çështjet që nuk është ndjekur procedura e shortit, për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Kemi propozuar, siç kemi propozuar edhe në relacionin që është paraqitur në mbledhjen e datës 19 shkurt, që gjykata nga duhet të caktohen gjyqtarët për gjykimin e këtyre 2 çështjeve, për të cilat kërkohet caktimi i një gjyqtari, të jetë po Gjykata e Apelit Korçë. Të konsiderohet shorti i hedhur në atë rast si për të gjithë çështjet e tjera, short i cili ka përzgjedhur tre gjyqtarët e apelit Korçë, që janë {...}, {...} dhe {...}, dhe ndërmjet këtyre tre gjyqtarëve të caktuar tashmë për gjykimin e disa çështjeve të tjera në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, të bëhet shorti për dy çështjet për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, që është çështja nr. 1 dhe çështja nr. 4 (referuar relacionit që është përfshirë në mbledhjen e datës 19 shkurt).

Jeni dakord që të vijojmë procedurën e pambyllur të shortit të datës 19 për sa i përket Gjykatës së Apelit Gjirokastrë?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, administrata duhet të marrë një enë. Në një enë të vendosi çështjet, nr. 1 dhe nr. 4 (që janë numrat e çështjeve), ndërsa në enën tjetër duhet të vendosi emrat e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë, {...}, {...} dhe {...}.

Vijojmë shortin. Po zgjedhim një nga numrat e çështjeve – nr. 4.
Tani po zgjedhim gjyqtarin që duhet të caktojmë për këtë çështje – është {....}.
Çështja tjetër është çështja nr. 1. Do të zgjedhim emrin e njërit prej gjyqtarëve –
që është {....}.
Me kaq mbyllet shorti sa i përket shtesës së vendimit që duhet të marrim sa i
përket Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 28.02.2019)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 14:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj pike anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja **Brunilda Kadi**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.**
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.**
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.**
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.**
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.**
- 6. Përfaqësues të USAID-it.**
- 7. Përfaqësuese e OSBE-së.**
- 8. Përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit.**

RENDI I DITËS:

7. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

(Zoti Toska hidhet tek çështja e fundit e rendit të ditës, direkt pas shqyrtimit të pikës së 6-të.)

Do vijojmë procedurat për caktimin edhe të gjyqtarit në dy çështje të tjera të veçanta. Një është në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër dhe një është në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ku na referohet nga kryetarët se janë çështje urgjente.

Naureda Llagami: Kjo është pika 7 e rendit të ditës?

Ilir Toska: Po!

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek pika 7 e rendit të ditës e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin.

Për më shumë detaje, ia kalojmë relatimin e këtij projekt-akti, zotit Toska.

Ilir Toska: Nga ana e kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është bërë një kërkesë për caktimin e 1 gjyqtari për një çështje penale. Është referuar si çështje urgjente. Kemi përgatitur relacionin për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë lidhur me këtë kërkesë.

Kemi parashtruar në relacion pazbatueshmërinë e skemës së delegimit për mungesë të gjyqtarëve në skemën e delegimit.

Kemi referuar në relacion pazbatueshmërinë e mekanizmit të transferimit të përkohshëm në këtë gjykatë, pasi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk ka pozicion të lirë të përkohshëm.

Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1 sepse aq është kërkuar.

Kemi paraqitur dy variante sa i përket gjyqtarëve. Varianti i parë konsideron shortin që kemi bërë një javë më parë, në funksion të caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ku në atë rast, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër janë përzgjedhur 2 gjyqtarë, gjyqtarët {...} dhe {...}. Ndërkohë, për çështjen të cilën na kërkohet, kërkohet vetëm 1 gjyqtar dhe 1 nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër që ne kemi përzgjedhur më herët është caktuar pikërisht për këtë çështje dhe gjyqtari që mbetet mund ta caktojmë gjyqtarin tjetër të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër që e kemi përzgjedhur më herët, pra gjyqtaren {...}.

Në opsionin që nuk pranohet ky propozim, varianti i dytë është që duhet të përzgjedhim një nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër të seksionit penal. Pra duhet të bëjmë një procedurë shorti. Nëse pranohet varianti i parë, nuk ka nevojë për procedurë shorti. Gjyqtarja {...} caktohet për t'u përfshirë në trupin gjykues për çështjen që kërkohet, në të kundër duhet të vijojmë procedurën e shortit. Pra mund të hidhni në votim variantin e parë dhe pas kësaj mund të operojmë.

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim për këtë?

Jo!

Atëherë, kalojmë në votimin e variantit të parë të propozuar nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Illir Toska: Atëherë, për çështjen për të cilën kërkohet caktimi i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, i bie që Këshilli të vendosi që gjyqtari që do caktohet të jetë gjyqtarja {....}, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me kaq mbyllet kjo.

Kemi edhe një çështje e cila na kërkohet nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë. Është vetëm një çështje ku kërkohen 3 gjyqtarë.

Kemi referuar pazbatueshmërinë e mekanizmit të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm.

Kemi propozuar që për çështjen e vetme gjyqësore për të cilën kërkohet caktimi i një gjyqtari të jetë Gjykata e Apelit Korçë, ndërsa numri i gjyqtarëve të jetë 3 sepse aq është kërkuar nga ana e kryetarit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Edhe në këtë rast kemi propozuar 2 variante. Duke konsideruar vijimin e procesit të mëparshëm të ndarjes së çështjeve të veçanta për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë (pra mbledhjen e bëmë para 1 jave më datë 19 shkurt), pra tre gjyqtarët që kemi përzgjedhur nga Gjykata e Apelit Korçë për gjykimin e disa çështjeve të tjera të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, të jenë po të njëjtët gjyqtarë që të gjykojnë edhe këtë çështje që referohet si çështje urgjente. Në të kundërt, varianti tjetër është të bëhet një short po nga 4 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, për të përzgjedhur 3 prej tyre, për të gjykuar këtë çështje. Nëse pranohet varianti i parë, duhet të bëjmë shortin vetëm për gjyqtarin relator. Kemi konsideruar që gjyqtarja {....}, ndërsa është ngarkuar më tepër nga dy gjyqtarët e tjerë, si relatores, të mos caktohet në këtë rast si relatores, por gjyqtari relator të zgjidhet mes dy

gjqtarëve të tjerë {...} dhe {...}. Po kështu edhe në variantin e dytë, nëse do të përzgjidhet përsëri gjyqtarja {...} (mes 4 gjyqtarëve) të mos jetë ajo gjyqtarja relatores për shkak se ka marrë një ngarkesë më tepër nga gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate, në rastin e caktimit të gjyqtarëve për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, të bërë në datë 19 shkurt.

Mund të votojmë variantin e parë dhe në varësi të kësaj, vijojmë me variantin e dytë që kërkon një procedurë shorti.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim propozimin e parë të bërë nga kryetari i Komisionit.

Maksim Qoku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Atëherë, duhet të bëjmë vetëm shortin për gjyqtarin relator që duhet të marrim këtë çështje. Duhet të bëhet shorti mes gjyqtarëve {...} dhe {...}.

Naureda Llagami: Okej! Dakord!

Vijojmë me procedurën e shortit ndërmjet këtyre dy gjyqtarëve, kush nga këto do jetë relatori i çështjes.

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: Nga procedura e shortit u përzgjedh si gjyqtar relator për çështjen për të cilën kërkohet caktimi i tre gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, gjyqtari {...}, i Gjykatës së Apelit Korçë.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, lidhur me çështjet e propozuara në rendin e ditës, besoj se u ezauruan.

Unë në fakt kisha edhe një çështje tjetër për ta diskutuar.

Siç jeni vënë në dijeni, Kuvendi i Shqipërisë miratoi numrin total të personelit që duhet të ketë Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke përcaktuar si pikë të dy të këtij vendimi edhe hartimin e një VKM-je për çeljen e fondit për llogari të KLGJ-së. Ajo që më është lënë gjatë relatimit të strukturës, pra propozimin për numrin e punonjësve dhe strukturave në Kuvendin e Shqipërisë, na është vënë si detyrë që neve, lidhur me pjesën e pagave, për stafin që ne do rekrutojmë dhe do kemi këtu midis nesh, duhet të koordinojmë me drejtoreshën e Departamentit të Administratës Publike. Unë besoj që këtë lloj takimi do ta ezaurojmë shumë shpejt dhe unë sugjeroj që përpara se ne të bëjmë VKM-në, strukturën me numrat e rinj të punonjësve, ta kalojmë edhe një herë në mbledhjen e përgjithshme, me idenë pastaj që t'ia bashkëlidhim dokumenteve dhe akteve që i duhen për hartimin e VKM-së. Kështu që, për efektivitet më të mirë, unë do doja që këtë mbledhje ta kemi fleksibël. Ndoshta kjo mbledhje mos të ketë detyrimisht edhe akte të tjera. Në momentin që ne jemi gati për strukturën, ndoshta edhe të hënë dhe të martë, është e mira që ne të gjejmë kohë, edhe mbas dite qoftë, thjesht për ta kaluar, me idenë që të procedojmë sa më shpejt për zhblokimin e buxhetit të KLGJ-së.

Kaq kisha unë si informim lidhur me pjesën e strukturës.

Nëse keni ndonjë gjë tjetër, jeni të hapur për diskutim.

Atëherë, faleminderit për pjesëmarrjen!

Ju uroj, ditë të mbarë!

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor